



VENDIM
Nr.11 Datë 08.02.2010
PËR
LICENSIMIN E SHOQËRISË
“HIDROALBANIA ENERGJI” SH.P.K

Në mbështetje të neneve 8, pika 2 gërma “a”, nenit 9 dhe 13 pika 1, gërma “a”, të Ligjit nr.9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, nenit 4, pika 1, gërma “a”, nenit 5 pika 1 gërma “a”, nenit 13 dhe nenit 14 pika 1 të “Rregullores për Proçedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit të Plotë/Pjesshëm dhe Rinovimit të Liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr.108, datë 09.09.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 08.02.2010, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “HIDROALBANIA ENERGJI” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi liçensimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie

Konstatoi se:

Aplikimi plotëson përgjithësisht kërkesat e ERE-s lidhur me liçensimet në sektorin e energjisë elektrike të:

- **Formatit të aplikimit (neni 9, pika 1)**
- **Dokumentacionit juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2)**
- **Dokumentacionit finaciuar dhe fiskal (neni 9, pika 3)**
- **Dokumentacionit teknik (neni 9, pika 4)**

Per Dokumentacionin që ka të bëjë me: Miratimin e OST-s ose OSSH-s per lidhjen e centraleve me sistemin elektroenergjetik, aplikuesi është në pritje të miratimit të saj për ta paraqitur më pas në ERE.

Për gjithë sa më sipër Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

Vendosi:

1. Liçensimin e shoqërisë “HIDROALBANIA ENERGJI” shpk ne aktivitetin e prodhimit te energjise elektrike me kusht qe te paraqese dokumentin e miratimit

te pikes se lidhjes me sistemin elektroenergjetik para fillimit te operimit te HEC-ve.

REPUBLIKA E SHQIPERISE
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE
Bordi i Komisionereve



-
2. **HIDROALBANIA ENERGJI** shpk të fillojë ushtrimin e aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike nga HEC Borje, Oreshke, Cernaleve, Cernaleve 1 sipas afatit të përcaktuar në marrëveshjen e koncesionit.
 3. Afati i vlefshmerise se licenses te jete 30 vjet.
 4. Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit te Tregut te njoftojne aplikuesin per Vendimin e Bordit te Komisionereve te ERE-s

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Kryetari i ERE-s

Bujar Nepravishta

